



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

V E N D I M

Nr. 6 datë 18/01/2019

“Për

Miratimin e rinovimit të lejes “për përdorim burimi ujqor”, për prodhim hidroenergjie, subjektit “IRARBA ENERGJI”, për HeC “SHENGJUN”, me vendndodhje: Burimet e Traverbangut, përroi i Bejnit, degë e Lumit Mat, në fshatin Klos-Katund, Bashkia Klos, Qarku Dibër”.

- Në mbështetje të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, nenit 7 pika 2, nenit 41, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore”, të ndryshuar, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujqore”, kontratës koncesionare të tipit BOT (për ndërtim, operim dhe transferim) me nr. 10335 Rep. dhe nr. 3329 Kol. Dt. 09.09.2013, Kontratës shtesë koncesioni nr. 240 Rep. dhe nr. 86 Kol. Dt 05.04.2016 me Ministrinë e Energjitikës dhe Industrisë për një periudhë 35 vjeçare, me propozim të A.B.U. Mat,

Këshilli i Basenit Ujqor Mat;

Vendosi:

1-Miratimin e rinovimit të Lejes së Përdorimit të Ujit për prodhim të energjisë elektrike, shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, me Administrator Z. Bruno Mara, me këto të dhëna:

- Burimet e Traverbangut, Përroi i Bejnit, degë e lumit Mat, në fshatin Klos-Katund, Bashkia Klos, Qarku Dibër, subjektit “IRARBA ENERGJI” sh.p.k

HEC - “SHENGJUN”

	Vepra e marrjes 1		
- Prurja mesatare	$Q_{mes} = 1.53 \text{ m}^3/\text{sek}$		
- Prurja llogaritese	$Q_{llog} = 2.2 \text{ m}^3/\text{sek}$		
- Prurja ekologjike	$Q_{ekol} = 0.207 \text{ m}^3/\text{sek}$		
- Kuota e Vepra e marrjes :	X - 5 11 035.536	Y - 45 94 861.290	Z - 373.55 m.m.n.d
- Kuota e godines se HEC :	X - 5 07 622.223	Y - 45 95 897.734	Z - 257 m.m.n.d
- Fuqia totale e instaluar :	<u>N = 2040 kW</u>		
- Energjia mesatare vjetore totale:	<u>E = 8 579 081 kWh/vit</u>		

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me uje të popullatës e tjere, nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I Z.A.B.U. ISHEM-ERZEN-MAT
Adrian SHTINO

KRYETARI I K.B.U. MAT
Gjergj PRENDI

